

Kompania Rajonale e Ujësjetës
SH.A.



Zyret Qëndrore – Zyra për Media
rr. 'Lekë Dukagjini' Nr, 156 / 30000 Pejë
email: zip@hidrodrini.com
telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

KRU 'HIDRODRINI' - Pejë
Sektori i Kanalizimit

SQARIM MBI FUSHËVEPRIMIN E SHËRBIMEVE TË SEKTORIT TË KANALIZIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjetës 'Hidrodrini' Sh.A., krahas furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët, ofron gjithashtu edhe shërbime të rëndësishme që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit.

Këto shërbime janë pjesë e përkushtimit të kompanisë për të ofruar kushte sa më të mira higjieno-sanitare dhe për të mbrojtur mjedisin, në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e qytetarëve.

Përmes ekipeve të mirëmbajtjes dhe operimit, KRU 'Hidrodrini', kujdeset për funksionimin e rregullt të rrjetit të kanalizimit publik, duke përfshirë:

- **DEBLLOKIMI DHE PASTRIMI I PUSETAVE TË KANALIZIMIT,**
- **MIRËMBAJTJA E PUSETAVE DHE KAPAKËVE,**
- **MIRËMBAJTJA E RRJETIT KRYESOR (NË RRUGËT KRYESORE DHE LAGJE),**
- **RENOVIMI I PRISHJEVE NË RRJETIN KRYESOR TË KANALIZIMIT.**

Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se disa shërbime që lidhen me sistemet e kanalizimit brenda pronave private apo me infrastrukturë që nuk është pjesë e rrjetit publik, **NUK** përfshihen në përgjegjësitë e kompanisë, siç janë:

- o **MIRËMBAJTJA DHE ZBRAZJA E GROPAVE SEPTIKE,**
- o **PASTRIMI I NËNKALIMEVE,**
- o **PASTRIMI I KANALEVE TË HAPURA,**
- o **RIPARIMI I GYPAVE SHTËPIAK,**
- o **RIPARIMI DHE FURNIZIMI I PUSETAVE SHTËPIAKE,**
- o **MIRËMBAJTJA DHE DEBLLOKIMI I RRJETEVE SHTËPIAKE (GYPAT NË OBORRE).**

Për më shumë informacione, qytetarët janë të mirëseardhur të kontaktojnë kompaninë për sqarime shitesë rreth fushëveprimit të shërbimeve që ofrohen.

Vërejtje: Për çdo kërkesë për deblokim ose punë konform shërbimeve të lartëcekura, që kompania i mbulon në rrjetin e kanalizimit, duhet të bëhet kërkesë me shkrim në zyrat e KRU 'Hidrodrini' ose përmes emailit; info@hidrodrini.com

Pejë, Më: 17.04.2025



Me respekt:
Zyra për Media e KRU 'Hidrodrini'-Pejë